



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1260 Prot.

Lezhë, më 31 . 1 . 2024

VENDIM

Nr. 6, Datë 30. 01. 2024

PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 74, DATË 14.12.2023
“PËR MIRATIMIN E LINJAVE TË TRANSPORTIT TË NXËNËSVE E MËSUESVE,
QENDRAVE TË GRUMBULLIMIT E BILETAVE”

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”; VKM nr. 119 datë 01.03.2023 “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, me propozim të ZVAP Lezhë dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

Vendosi:

1. Ndryshimin e hartës së linjave të transportit të mësuesve sipas shkollave dhe linjave përkatëse, distancat në kilometra, qendrat e grumbullimit të mësuesve në vendbanimin e tyre të përhershëm, si dhe çmimet e biletave të indeksuar me normën e inflacionit. Bashkëngjitur, harta e linjave.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike Infrastrukturës, Transportit e Mjedisit.
3. Një kopje e këtij vendimi, i dërgohet Z.V.A.P., Lezhë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI



Harta e linjave të transportit të mësuësve për vitin 2024

LINJAT PËR MËSUËS BRENDA ZVAP -së LEZHË

II	LINJAT PËR MËSUËS BRENDA ZVAP -së LEZHË						Tarifa/ Çmimi i biletës vetëm vajtje pa tvsh	Tarifa/ Çmimi i biletës vajtje- ardhje pa tvsh	Ilek
Linjat e punonjësve nësimorë e jo nësimorë, brenda rrethit	IA (Shkolla ku SHKOJNË mësues)	Largësi në km	Katego ria e Rrugës	Qendra e Grumbullimit	Tarifa/ Çmimi i biletës vetëm vajtje pa tvsh	Tarifa/ Çmimi i biletës vajtje- ardhje pa tvsh	Ilek		
1	Lezhë - Balldre - Rraboshtë	10	III	Lezhë te gjimnazi, Balldre e Rraboshtë te shkolla	65	130	130		
2	Lezhë - Kallmet	15	III	Lezhë te gjimnazi, Kallmet te shkolla	100	200	200		
3	Lezhë - Kakarriq - Gjadër	14	III	Lezhë te gjimnazi, Kakarriq, Gjadër te shkolla	100	200	200		
4	Lezhë - Kolsh	6	III	Lezhë te gjimnazi, Kolsh te shkolla	65	130	130		
5	Lezhë - Tresh - Spiten - Zejmen Pllanë	12	III	Lezhë te gjimnazi, Tresh, Spiten, Zejmen e Pllanë te shkolla	65	130	130		
6	Lezhë - Tale - Grykë Lumi	24	III	Lezhë te gjimnazi, Tale e Grykë Lumi te shkolla	150	300	300		
7	Lezhë - Barbullojë - Rilë - Shënkoll	16	III	Lezhë te gjimnazi, Barbullojë, Rilë e Shënkoll te shkolla	100	200	200		
8	Lezhë - Shëngjin	8	III	Lezhë te gjimnazi, Shëngjin te shkolla	65	130	130		
9	Shëngjin - Lezhë	8	III	Shëngjin te shkolla, Lezhë te gjimnazi	65	130	130		
10	Lezhë - Blimisht - Troshan	21	III	Lezhë te gjimnazi, Blimisht te sheshi, Troshan te shkolla	120	240	240		
11	Lezhë - Dajç - Mabë	18	III	Lezhë te gjimnazi, Dajç te shkolla, Mabë te shkolla	120	240	240		
12	Lezhë - Torovicë - Malecaj - Kolajakë	26	III	Lezhë te gjimnazi, Torovicë, Malecaj e Kolajakë te shkolla	150	300	300		
13	Lezhë - Ungrej - Kalivaç	35	IV	Lezhë te gjimnazi, Ungrej qendër, Kalivaç te shkolla	320	640	640		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 108/4 Prot.

Lezhë, më 01.02 2024

Lënda: **Konfirmim vendimi**

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për dijeni: **KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", VKM-në nr. 119, datë 1.3.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", në VKM-në nr. 89, datë 14.02.2018 "Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 6, datë 30.01.2024 "Për një ndryshim në vendimin nr. 74, datë 14.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për miratimin e linjave të transportit të mësuesve dhe të nxënësve, qendrave të grumbullimit e biletave".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

